

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7167
E premte, 19 prill 2024
Çmimi 0.50 €

Edhe një raund i pasuksesshëm në Bruksel për dinarin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PROF. DR. KUDUSI LAMA, GJENERAL NË PENSION (2)

JAM I SIGURT NË PAFAJËSINË E LIDERËVE TË UÇK-së

FAQE 4-5

- Më shumë shqetësohem për këta që udhëheqin shtetin sesa për ata që janë atje në Hagë sepse ata dinë si fitohet lufta



Gjenerali në pension, prof. dr. Kudusi Lama, në pjesën e dytë të intervistës dhënë "Epokës së re", ka shprehur bindjen se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi do të dalin të pafajshëm në përfundim të procesit gjyqësor në Hagë. Ai ka

theksuar se "deklarimi i Shaun Byrnes, se nuk ka parë kurrë prova që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka urdhëruar kryerjen e ndonjë krimi, është tregues se kjo prokurori ka dështuar në pretendimet e saj". "Jam i bindur se ata do të dinë ta tregojnë

botërisht portretin e tyre, të ushtrisë së tyre dhe të luftës së tyre, ashtu si dje në luftë", ka thënë ai. Lama ka kërkuar nga institucionet e Kosovës t'i kryejnë detyrat që i kanë të përcaktuara me ligj sa iu përket liderëve të UÇK-së

KOSOVËS I SHTOHEN EDHE 445 POLICË TË RINJ

F. 6



STËRZGJATJA E PROCEDURAVE KUNDËR ISH-PRESIDENTIT THAÇI NGA SPECIALJA, KËRKOHEM INTERPELANCË NË PARLAMENTIN E ZVICRËS

F. 6

RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KNAUS: KOSOVA TA DËRGOJË DRAFTIN E ASOCIACIONIT NË KUSHTETUESE PARA VOTIMIT NË MAJ
F. 2

SHQIPËRIA THOTË SE DO TA KTHEJË NË FUNKSION INDUSTRIJËN E VJETËR USHTARAKE
F. 2

OSMANI NDEROHET ME ÇMIMIN E EVROPËS NGA FONDAÇIONI PAN-EVROPIAN
F. 3

EKONOMI



BIZNESET E PAINFORMUARA PËR EKZISTIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE
F. 8

KESCO PO VIZITON BIZNESET ANEKËND VENDIT
F. 8

SPORT



5 FITORE PËR 7 MUAJ, MERSIM ZEQIRI SYNON T'I FITOJË DY TITUJ NË FSHATIN E TIJ GARANË
F. 12

Knaus: Kosova ta dërgojë draftin e Asociacionit në Kushtetuese para votimit në maj



PRISTINË, 18 PRILL - Gerald Knaus, nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet, thotë se votimi pro Kosovës në Asamblenë e Përgjithshme të Këshillit të Evropës është "sinjali më i fuqishëm i mundshëm" që mori vendi në rrugën drejt anëtarësimit në këtë organizatë. Por, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai thotë se qeveritë e shumë shteteve nuk kanë vendosur ende se si do të votojnë në maj - kur pritet vendimi përfundimtar. Andaj,

Kosova duhet të bëjë disa "befasi pozitive" në javët e ardhshme, thotë ai. "Këshilla ime do të ishte ta dërgonte draft-statutin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese", thotë Knaus. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës votoi mbrëmjen e së martës pro anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë. Megjithatë, disa deputetë theksuan se vendi duhet të ndërmerret hapa konkretë drejt

themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe përpara votimit përfundimtar në maj. Knaus thotë se themelimi i këtij asociacioni "pa pjesëmarrjen e atyre për të cilët bëhet, nuk është i mundur". "Pra, duhet të jemi të drejtë - ka gjëra që Qeveria e Kosovës mund t'i bëjë dhe ka gjëra që nuk mund t'i bëjë", thotë ai, organizata e të cilit ka publikuar së voni një dokument për rrugën e Kosovës drejt Këshillit të Evropës.

Shqipëria thotë se do ta kthejë në funksion industrinë e vjetër ushtarake

TIRANË, 18 PRILL - Shqipëria do ta rijetësojë së shpejti industrinë e vjetër ushtarake. Kështu deklaroi ministri shqiptar i Mbrojtjes, Niko Peleshi, gjatë një interpelance në Kuvendin e Shqipërisë, e cila ishte thirrur nga kryetari i Komisionit për Sigurinë, Nasip Naço, i cili vjen nga radhët e Partisë Socialiste. Peleshi theksoi se rivënia në funksion të industrisë së vjetër ushtarake ka lindur si nevojë pas ndryshimeve gjeopolitike. "Pas agresionit rus, situata gjeopolitike ka ndryshuar, arkitektura e sigurisë ka ndryshuar. Ne jemi në një periudhë ku paqja është më e kërcënuar se kurrë. Kjo situatë sfidoi bazën industriale globale të mbrojtjes - kërkesë e lartë për municione dhe sistem armatimesh", tha Peleshi. Ministri theksoi se me ndihmën e Agjencisë së Prokurimit Publik të NATO-s është hartuar një raport mbi gjendjen e objekteve të industrisë ushtarake në Shqipëri. Sipas tij, ky raport i ka njoftuar edhe me nevojat që ka tregu. "Nga tetori i

vitet 2022 kemi kërkuar bashkëpunimin e Agjencisë së Prokurimeve të NATO-s. I kërkuam të hartojë një raport, parafizibilitet, që të dimë se çfarë kemi, vlerën e asaj që kemi, linjat e prodhimit, por edhe se cilat janë kërkesat e tregut. Tashmë e dimë vlerën e aseteve, kërkesën globale dhe mund të orientohemi më mirë për të vendosur se çfarë game produktesh duhet të marrë mbështetje", theksoi ministri Niko Peleshi.

Ministri shqiptar i Mbrojtjes tha se kjo kërkon disa ndryshime ligjore në mënyrë që shteti shqiptar të përfitojë nga kjo industri. Peleshi tha se investitorë dhe kompani të huaja që synojnë prodhimin e armëve dhe municioneve kanë treguar interes, ndërsa shtoi se Shqipëria synon të jetë partnere si aksionare në biznes dhe jo thjesht t'i japë ato me koncesion. "Ndër vite ka pasur investitorë nga Turqia, Hungaria, Izraeli, Kroacia të cilëve u kemi dhënë mundësinë të njihen me këtë industri. Nuk kemi projekt



të konkretizuar, po punojmë për ta ndryshuar qasjen edhe në kuptimin se si sillmi në raport me këto investime. Duam të ikim nga projekti 'Shqipëria 1 euro' dhe të shkojmë te Shqipëria partnere, aksionare, të marrim edhe dividendën si pronar i këtyre aseteve", u shpreh ministri gjatë seancës parlamentare. Interpelanca ishte thirrur nga deputeti socialist, kryetar i Komisionit për Sigurinë, Nasip Naço. Ai tha se përgatitja për këtë projekt duhet të jetë reale dhe se

Shqipëria është e vonuar në këtë proces, pasi vende të tjera e kanë vënë në funksion këtë industri dhe po shesin municione. "Nëse nuk bëhet, kjo është mungesë sigurie, cenon sigurinë kombëtare dhe ekonominë tonë. Është koha të viheni në dispozicion për ta vënë në punë industrinë ushtarake", u shpreh Nasip Naço.

Një ditë më parë Qeveria e Shqipërisë miratoi një vendim për t'i paguar pagat e mbetura dhe sigurimet shoqërore për periudhën 2017-2023 për 131 ish-punonjësit e

Kombinatit të Policanit. Naço tha se ky vendim është marrë shumë vonë dhe pretendoi se janë 241 punonjës që duhej të përfitonin dhe se do të jenë ata që do ta vënë në punë këtë industri.

Propozimin që në Shqipëri të prodhohen armë dhe municione, e bëri nga Tirana presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, gjatë vizitës së tij më 29 shkurt.

Ndërsa kryeministri Edi Rama shprehu ambicien që brenda vitit 2030 Shqipëria të

kryejë eksporte ushtarake të markës "Made in Albania".

Në Kuçovë, më 4 mars, u përrua baza ajrore taktike e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e para bazë e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë bazë janë vendosur tre dronë të prodhimit turk Bayraktar.

Ndërkaq pak ditë më parë është publikuar edhe dokumenti mbi strategjinë e sigurisë kombëtare, që synon modernizimin e forcave të armatosura për t'u përgjigjur sfidave të reja sigurisë.

Dhoma e Përfaqësuesve voton këtë javë për ndihmën për Ukrainën dhe Izraelin

WASHINGTON, 18 PRILL - Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara do të votojë për ndihmën për Ukrainën, Izraelin dhe Indo-Paqësorin të shtunën, më 20 prill, tha kryetari i Dhomës, republikani Mike Johnson.

Një komitet i Dhomës bëri publike legjislacionin që parasheh ndihmë të sigurisë në vlerë prej më shumë se 95 miliardë dollarësh, përfshirë 60.84 miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën, e cila po përballet me pushtimin e nisur nga Rusia më 2022.

Në projektligjin për Izraelin përfshihen 26.38 miliardë dollarë ndihmë për Izraelin, shumë që do të mbulojë edhe kostot e operacioneve ushtarake amerikane që u kryen në përgjigje të sulmeve të



fundit. Ndërkaq, 9.1 miliardë dollarë janë dedikuar për ndihmë humanitare, edhe pse në legjislacion thuhet se asnjë ndihmë financiare nuk do të shkojë për Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për refugjatët palestinezë (UNRWA).

Projektligji parasheh një ndihmë prej 8.12 miliardë dollarësh për

Indo-Paqësorin. Johnson tha se anëtarët e Dhomës do të kenë kohë deri mesditën e së shtunës që ta rishikojnë projektligjin dhe t'i ofrojnë ndryshimet e tyre para se ai të dërgohet për votim përfundimtar. Ai tha se do të publikohet edhe një projektligj i posaçëm për sigurinë kufitare që, sipas tij, plotëson

kërkesat e konservatorëve.

Presidenti amerikan Joe Biden i ka bërë thirrje Kongresit ta miratojë me shpejtësi projektligjin.

Të tri projektligjet janë të ngjashme me paketën për ndihmë financiare në vlerë prej 95 miliardë dollarësh që Senati miratoi në shkurt. Por, Johnsoni nuk kishte vendosur të hidhte në votim ndihmën deri më tani për shkak të kundërshtimeve nga ligjvënësit e krahut të djathtë.

Në legjislacionin për Ukrainën, në një nen shkruan se ndihma ekonomike për Kievin - jo ushtarake duhet të shlyhet, që ka qenë kërkesë e konservatorëve. Megjithatë, administrata Biden mund ta heqë këtë kërkesë.

Pas prezantimit të këtyre tri projektligjeve, udhëheqësit e

Dhomës të mërkurën mbrëma paraqitën edhe projektligjin e katërt për siguri kombëtare, që do të jetë e kësaj pakoje ligjesh. Në të përfshihen disa nene që nuk kanë qenë pjesë e projektligjit të miratuar në Senat, përfshirë edhe nenet ku thuhet se lejohet transferimi i aseteve të ngrira ruse për ta ndihmuar Ukrainën dhe për të vendosur sanksione ndaj Iranit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian.

Ndihma për Ukrainën është kundërshtuar fuqishëm nga ligjvënësit konservatorë. Ukraina vazhdimisht ka bërë thirrje për dhënien e ndihmës, pasi po përballet me mungesë të sistemeve të mbrojtjes ajrore dhe municioneve.

MBAHET CEREMONIA E DIPLOMIMIT TË GJENERATËS SË 59 TË POLICISË SË KOSOVËS

Kosovës i shtohen edhe 445 policë të rinj

Në një ceremoni të mbajtur në sallën "1 Tetori" në Prishtinë kanë diplomuar 445 kadetë të Policisë së Kosovës, prej tyre 345 meshkuj, 100 femra. Pas përfundimit të ceremonisë, të sapodiplomuarit shprehën emocionet dhe krenarinë e thellë për angazhimin e tyre të ri në shërbim të qytetarëve të Kosovës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 PRILL - Në sallën "1 Tetori" në Prishtinë ka diplomuar të enjten gjenerata e 59 e Policisë së Kosovës në përbërje të komuniteteve të ndryshme. Këtë ceremoni solemne, me praninë e tyre, e nderuan edhe personalitetet më të larta shtetërore: presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, zëvendësministra, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, eprorë dhe zyrtarë të Policisë së Kosovës si dhe familjarë të kadetëve policorë që diplomuan sot.

Në këtë ceremoni u bë ndarja e certifikatave për pranimin e detyrës së re si dhe u realizua betimi nga të gjithë të diplomuarit e kësaj gjenerate. Personalitetet e larta shtetërore dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, të pranishmëve iu drejtuan me nga një fjalë rasti, duke uruar kadetët policorë për diplomimin e tyre si

dhe u dëshiruan mirëseardhje në familjen e madhe policore.

Osmani ka thënë se betimi i sotëm i policëve të rinj është përgjigja më e fuqishme në përbërjen me sfidat e sigurisë në vend dhe rajon.

Presidentja Osmani tha se "kërcënimet dhe rreziqet janë përditshmëri e jona ndaj është domosdoshmëri që Republika e Kosovës me institucionet e saj të jetë anëtare fuqiplohtë e INTERPOL-it dhe e EUROPOL-it". Kryeministri Albin Kurti ka përshkruar ndjenjën e tij në ceremoninë e diplomimit të policëve dhe të ushtarëve teksa kërkoi nga ta ta respektojnë uniformën. "Është gjithmonë ndjenjë e veçantë sa herë bashkohem në ceremoninë e diplomimit të policëve dhe të ushtarëve të Kosovës sepse u takojnë institucioneve që kujdesen ditë e natë për rendin dhe ligjin. Sivjet Policia mbush çerek shekulli. Republika e Kosovës rri mbi shtyllat e progresit të vazhdueshëm. Nga sot, pasi të jeni betuar, ëndrra juaj e dikurshme do të kthehet në realitet. Respektojeni dhe nderojeni uniformën ashtu siç jeni trajnuar. Paçi karrierë të



mbarë", ka thënë Kurti.

Me rastin e diplomimit të gjeneratës së 59 të Policisë së Kosovës, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se është i lumtur që sot po shënojnë këtë ditë të rëndësishme për Policinë e Kosovës. "Jam shumë i lumtur që sot jam këtu me ju dhe bashkërisht po shënojmë këtë ditë të rëndësishme për Policinë e Kosovës dhe Republikën tonë. Nga sot ju do të jeni pjesë e një organizate të madhe, e ngritur mbi parimet e shërbimit të barabartë për të gjithë qytetarët tanë dhe garantimin e sundimit të rendit dhe ligjit në çdo cep të

territorit të Republikës së Kosovës. Këtu para nesh, para familjarëve tuaj e mbarë vendit tonë, ju sot do të betoheni për respektim të Kushtetutës sonë, mbrojtjen e sovranitetit e integritetit territorial të vendit tonë duke shërbyer drejt e paanshëm me profesionalizëm, përgjegjësi dhe ndershmëri. Këto janë parimet dhe vlerat e qarta të Policisë së Kosovës të cilat duhet t'i bartni në çdo ditë të punës suaj. Policia jonë, pjesë e së cilës nga sot do të jeni edhe ju, gëzon mirënjohje e vlerësim nga shoqëria jonë, të arritura këto falë punës së pandalshme të gjeneratave të tëra në forcimin dhe ngritjen e saj", ka thënë Sveçla.

Drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, duke iu drejtuar gjeneratës së 59 të policisë, u tha se kanë marrë vendimin e drejtë, duke e vënë veten në shërbim të vendit. "Të dashur policë të rinj të Republikës së Kosovës, mirë se vini në familjen tonë të madhe, Policinë e Kosovës, organizatën më të madhe të sigurisë në vend. Ju duhet të jeni krenarë që keni zgjedhur të bëheni pjesë e policisë sonë dhe unë besoj se ju nuk keni gabuar asgjë, por keni marrë një vendim të drejtë, duke vënë veten tuaj në shërbim të vendit, qytetarëve dhe komunitetit të cilit do t'i shërbeni", është shprehur Hoxha.



Osmani nderohet me Çmimin e Evropës nga Fondacioni Pan-European

PRISHTINË, 18 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është nderuar nga Fondacioni Pan-Evropian Richard Coudenhove-Kalergi me Çmimin e Evropës për përkushtimin e saj ndaj raporteve me partnerët euroatlantikë si dhe përkushtimin ndaj orientimit pro-evropian, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Në njoftimin e publikuar nga Fondacioni, presidentja Osmani është vlerësuar për qëndrimin politik dhe orientimin e saj të qartë evropian, duke e mbrojtur

atë me përkushtim, pavarësisht situatës delikate të sigurisë në rajon dhe kërcënimit të vazhdueshëm nga Serbia.

Më tej, në njoftimin e publikuar nga Fondacioni Pan-Evropian, presidentja Osmani është vlerësuar edhe për punën dhe përkushtimin e saj për demokracinë dhe sundimin e ligjit, si dhe për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Më tutje, në njoftim presidentja vlerësohet për qëndrimin e saj politik të ndjekur me bindje të

plotë ndaj rëndësisë së marrëdhënieve transatlantike, e cila në angazhimin e saj mbështet filozofinë e arkitektit të pavarësisë së Kosovës, ish-presidentit Ibrahim Rugova, i cili u nderua me po këtë çmim 20 vjet më parë.

Laureatët e këtij çmimi përfshijnë personalitete të ndryshme botërore, përfshirë edhe ish-kancelaren Angela Merkel, ish-presidentin amerikan Ronald Reagan dhe ish-presidentin Ibrahim Rugova.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, PROF. DR. KUDUSI LAMA, GJENERAL NË PENSION (2)

Jam i sigurt në pafajësinë e liderëve të UÇK-së

- Më shumë shqetësohem për këta që udhëheqin shtetin sesa për ata që janë atje në Hagë sepse ata dinë si fitohet lufta

Gjenerali në pension, prof. dr. Kudusi Lama, në pjesën e dytë të intervistës dhënë “Epokës së re”, ka shprehur bindjen se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi do të dalin të pafajshëm në përfundim të procesit gjyqësor në Hagë. Ai ka theksuar se “deklarimi i Shaun Byrnes, se nuk ka parë kurrë prova që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka urdhëruar kryerjen e ndonjë krimi, është tregues se kjo prokurori ka dështuar në pretendimet e saj”. “Jam i bindur se ata do të dinë ta tregojnë botërisht portretin e tyre, të ushtrisë së tyre dhe të luftës së tyre, ashtu si dje në luftë”, ka thënë ai. Lama ka kërkuar nga institucionet e Kosovës t’i kryejnë detyrat që i kanë të përcaktuara me ligj sa i përket liderëve të UÇK-së

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 18 PRILL -

“Epoka e re”: Para disa ditësh, me kërkesë të Departamentit Amerikan të Shtetit, ka dëshmuar edhe ish-shefi i Misionit Diplomatik Vëzhgues të ShBA-së në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Çfarë vlerësimi keni për dëshminë e tij dhe, sipas jush, çfarë ka nxjerrë në pah?

Gjenerali Lama: Duke parë se përgjithësisht dëgjimi i dëshmitarëve ka qenë i mbyllur për publikun, unë nuk mund të them saktësisht se çfarë po

ndodh në atë gjykim. Por sipas asaj sa dihet, po shihet se dëshmitarët përgjithësisht janë të manipuluar dhe të instruktuar për të bërë deklarata, prej të cilëve në mjaft raste po ndodhin luhatje dhe shmangie nga deklaratat e mëparshme deri edhe mohime të tyre. Prej nga gjykata në vend ta kërkojë origjinën e këtyre luhatjeve e mohimeve të deklaratave të mëparshme, për ta gjetur të vërtetën në veprimtarinë e prokurorisë pranë kësaj gjykate në bashkëpunim me prokurorinë e Beogradit, por tenton të bëjë deklarata të

papërgjegjshme se ata sillen në këtë mënyrë sepse i frikësohen hakmarrjes për dëshminë e tyre. Domethënë, megjithëse dëshmitarët kanë fshehtësi, kanë garanci, kanë mbrojtje, kanë shpërblime dhe përsëri po thonë se deklaratat e mëparshme që kanë bërë kundër UÇK-së janë të pasakta dhe se nuk ishte për shkak të frikës së hakmarrjes që ata e ndryshuan dëshminë e tyre. Përsëri gjykata gjen guxim të bëjë akuzë se po ia frikësojnë dëshmitarët të japin deklarata siç i kanë dhënë në prokurori. Po kush i frikëson? Këtë nuk e thotë. Megjithëse vetë dëshmitarët po i

thonë se nuk kemi presion, por kjo është e vërteta. Kush ka faj pse për të marrë dëshmi të rreme ka bërë manipulime prokuroria pranë asaj gjykate?

E tani ndodhi diçka që ndoshta gjykata nuk e priste. Aty erdhi për të dëshmuar kreu i Misionit Vëzhgues Diplomatik i Kosovës, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kohën e luftës Shaun Byrnes, i cili dëshmoi se ai nuk kishte asnjë provë se të luftëtarët që gjykohen të kishin urdhëruar rrëmbime a veprime që përbënin krime dhe që kishin dëmtuar civilë a njerëz të pa përfshirë në operacione luftarake. Megjithëse ai kishte qenë në Kosovë në kohën për të cilën akuzohen luftëtarët e mbyllur në Hagë.

Megjithatë unë do të dëshiroja që kjo gjykatë e themeluar si institucion nga Kosova dhe që i ka dhënë vetes pavarësi të tejskajshme, do ta kryej detyrën siç thirret sipas legjislacionit të Kosovës dhe siç thotë do të sigurojë që pretendimet për

krime lufte të UÇK-së të saktësohen dhe se do të shpallen fajtorët dhe të pafajshmit. Por, prokurorët, si ata që u arratisën ashtu edhe ata që janë prezent, jam i sigurt se kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë kundër Kosovës dhe luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse duhet të justifikojnë akuzat që kanë ngritur, me qëllimin që të fitojnë publicitet në media, për t’u dukur me vlera, duke bërë kështu dëme të pariparueshme, siç i mendojnë ata, por që jam i sigurt se do të dështojë gjithë ky makinacion i ngritur për të fituar para me të gjitha mënyrat dhe paga të larta për një periudhë të gjatë kohe.

Deklarimi i Shaun Byrnes, se nuk ka parë kurrë prova që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka urdhëruar kryerjen e ndonjë krimi, është një tregues se kjo prokurori ka dështuar në pretendimet e saj.

Jam i sigurt se dëshmitarë të tjerë, do ta demantojnë plotësisht gjithë ngrehinën me

mashttrim që ka ngritur kjo prokurori.

Por ajo që dhemb më shumë është deklarimi i Shaun Byrnes, se një intelektual në Kosovë në atë kohë i kishte thënë se UÇK-ja është një grup fshatarësh rebelë që janë ngritur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës. Dhe për këtë ai e kufizon deklaratën në tre persona, të cilët ose duhet t'i qëndrojnë publikisht asaj deklaratë ose duhet të pranojnë se kanë gabuar, ose i qëndrojnë edhe sot atij mendimi. Kjo vërtetë është jo vetëm e turpshme, por edhe shumë e dëmshme në planin kombëtar shqiptar dhe në planin qytetar. Lidhja Demokratike e Kosovës që nga krijimi i saj ka qenë dhe mbetet vlerë kombëtare shqiptare. Ajo asnjëherë nuk është deklaruar si instrument i Serbisë. Ajo në atë kohë gëzonte simpatinë e pjesës më të madhe të shqiptarëve në Kosovë. Dhe ajo pavarësisht nga orientimi për paqe i asaj kohe, sot e nderon Luftën Çlirimtare të Kosovës dhe Ushtrinë që e barti atë luftë. E të fshish nga trualli i Kosovës në atë kohë 70 mijë trupa ushtarake, 12 deri 20 mijë forca policore, 8 mijë forca paramilitare, 5 mijë forca ushtarake kriminale e vullnetare, si dhe 63 mijë forca të armatosura për vetëmbrojtje territoriale me qytetarët serb të Kosovës të armatosur dhe të organizuar për luftë dhe ta veshë UÇK-në përballë LDK-së nuk di se ka vepër më të madhe kundërkombëtare. Kush e ka bërë le t'i ndijë lezetin.

"Epoka e re": Shumica e dëshmitarëve në këtë proces deri më tani kanë dëshmuar me dyer të mbyllura. Pse mendoni së është duke ndodhur një gjë e

tillë?

Gjeneral Lama: Zakonisht fshihet e shëmtuara. Prandaj edhe mua më duket se po fshihet shëmtia e çfarë është organizuar dhe përgatitur nga sistemi i prokurorisë për të përgatitur akuzat e për t'i paraqitur ato para gjykatës me dëshmitarët e instruktuar. Përfundimisht duhet të jetë e qartë që ky gjyq nuk ka transparencë. Ata u munduan të bëjnë seanca të fshehta edhe me kreun e Misionit Vëzhgues Diplomatik i Kosovës, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kohën e luftës Shaun Byrnes. Kur ai bënte deklaratat dhe nuk i trembej askujt për ato që thoshte, pse duhej bërë fshehtësi?

Por në një mënyrë edhe ai duhej fshehur, sepse bënte deklaratat dhe jepte informacione që nuk i interesonin ose ishin në dëmin e prokurorisë. Siç ishte fakti që deklaroi se: Asnjëherë nuk mbaj në mend që Thaçi të jetë marrë në mënyrë të drejtpërdrejt me komandantët në terren. Ne e kemi takuar me pjesëtarë të tjerë të drejtorisë politike, dhe sipas përkufizimit, jo udhëheqës ushtarak, dhe kuptohet që nuk ka qenë udhëheqës ushtarak.

Ashtu sikurse deklarimi tjetër që realisht është i gjetur kur thotë se: "Shtabi i Përgjithshëm ka qenë si Ministria e Jashtme e UÇK-së. Kjo ka qenë ndjesia". Çka vërtetë tentohej të krijonte imazhin e një qeverie lufte.

Prandaj duhet të jetë e qartë se kjo lojë do të vazhdojë deri ditën e dështimit të kësaj prokurorie e përfundimisht nëse do të bjerë në kurthin e prokurorisë edhe në fundin e kësaj gjykate, që do të jetë dita e pafajësisë së luftëtarëve dhe e pastrimit

botërisht të çdo hapi të hedhur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës gjatë luftës së saj të lavdishme dhe që do t'i mbulojë me turp të gjithë ata që janë ngritur nga hiçi për të hedhur shpifje mbi UÇK-në, për të cilën shqiptarët janë krenar përjetësisht.

Por unë e di se Serbia dështoi ta shkatërroi UÇK-në me UDB-në e saj. Prandaj për të vijuar atë që nuk e realizoj në atë kohë të luftës, po punon fortë për të shkatërruar sa të mundet në këtë kohë. Dhe kam frikë se po gjen partnerë edhe ndër shqiptarët në Kosovës për ta realizuar këtë luftë. Prandaj edhe ata që ishin dje në rreshtat e saj kundër atdheut të tyre, ata janë edhe sot në funksionin e dëshmitarit të fshehtë për të akuzuar e montuar shpifje kundër disa prej udhëheqësve të luftës. Çka i jep mundësi Serbisë të deklarojë se edhe shteti i sotëm i Kosovës është i mbështetur në themele kriminale, pasi është i mbështetur pikërisht mbi luftën e UÇK-së.

"Epoka e re": Në bazë të dinamikës aktuale, sa prisni të zgjasë procesi gjyqësor në Hagë?

Gjeneral Lama: Aq sa të jepen para për të paguar prokurorët, aq do të zgjasë ky gjykim. Aq sa të ketë durim ta pranojë këtë gjykim populli i Kosovës. Aq sa të pranojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës të bëhet lojë me atë që quhet hapësirë e influencës së saj, siç janë territoret shqiptare në Ballkan. Deri në atë kohë do të zgjasë ky gjyq. Por një ditë do të përfundojë. Fatkeqësia qëndron në maltretimin e burrave të lavdishëm të kombit shqiptar që janë mbyllur e mbahen atje.

Por ky nuk është rast i vetëm. Në shtator të vitit 1912, kur po përgatitej pavarësia e Shqipërisë,

Serbia pa asnjë arsye do të arrestonte Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Idriz Seferin e të tjerë dhe do t'i dërgonte në burg në Beograd. Të cilët i mbajti të izoluar deri në vitin 1913 kur përfundonte konferenca e Londrës dhe pastaj një ditë të bukur u thanë ikni prej këtu se nuk kemi mundësi t'u ruajmë me bukë pa arsye.

Besoj nuk ka nevojë për koment se edhe aktualisht janë mbyllur atje burrat e fortë, sa të bëhen disa punë në mungesë të tyre dhe një ditë t'u thonë ikni prej këtu, por kur të vijnë ata nuk mund ta ndryshojnë më situatën, aq sa mundën ta ndryshojnë Hasan Prishtina, Bajram Curri, Idriz Seferi e të tjerë.

"Epoka e re": Muajt e fundit ka pasur ankesa në drejtim të institucioneve të Kosovës sa i përket financimit të avokatëve të liderëve të UÇK-së. A do të duhej që institucionet të jenë 100 për qind në mbështetje të mbrojtjes së liderëve të UÇK-së?

Gjeneral Lama: Unë nuk kërkoj asgjë më shumë prej institucioneve shtetërore në Kosovë, veç të bëjnë detyrën çka i obligon ligji. Në qoftë se nuk e bëjnë atë duhet të japin llogari para ligjit. Ndërsa për sa i përket sa duhet shteti i Kosovës të jetë në interesim e në mbështetje të burrave që i kemi të marrë pengë në Hagë, kjo ka të bëjë me ndjesinë sa ata persona që e përbëjnë shtetin e kuptojnë se vepra e atyre të marrë pengë është themeli i shtetit në kolltukët e të cilët janë ulur. Uniston Çurçilli ka thënë: "Unë isha vetëm shërbëtori i vendit tim. Dhe po të kishte pasur qoftë një moment të vetëm që të mos e kem treguar vendosmërinë time

të patundur për të luftuar dhe për të fituar, atëherë menjëherë do t'ua kisha hapur rrugën të tjerëve". A janë të pa vlerë ata burra pse kishin atë parim moral siç e kishte edhe Çurçilli? Mendoj se jo. Por që me luftën e tyre janë paraqitur të tillë për këtë unë jam dëshmitar dhe jam shumë i lumtur që e njoh veprën dhe luftën e tyre.

"Epoka e re": Gjeneral Lama, me çfarë optimizmi e prisni epilogun e procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së?

Gjeneral Lama: Unë jam krenar që kam rrugëtuar me ata burra dhe me të tjerët që janë në Kosovë e nëpër botë duke bërë jetën e tyre. Jam i sigurt në pafajësinë e tyre. Jam i bindur se ata do të dinë ta tregojnë botërisht portretin e tyre, të ushtrisë së tyre dhe të luftës së tyre, ashtu si dje në luftë.

Viktor Hygo ka thënë: "Ata që jetojnë janë ata që luftojnë". Prandaj ata e dinë çfarë po bëjnë dhe do ta bëjnë duke na bërë krenar, sepse janë nga ata që luftojnë. Ndërsa ata që janë përballë e kanë parë luftën nëpër libra, por është thënë se luftën e vërtetë kurrë nuk do ta gjeni nëpër libra. Kështu që ata nuk mund të jenë luftëtarë e për rrjedhojë do të dështojnë. Prandaj unë më shumë shqetësohem për këta që udhëheqin shtetin se sa për ata që janë atje në Hagë. Sepse ata dinë si fitohet lufta. Por këta nuk e di a dinë si organizohet paqja. Sepse pikërisht për këtë luftoi UÇK-ja e për këtë janë ata burrat në Hagë. Ata edhe atje janë të fortë se e kanë ndërgjegjen të qetë. Po këtu a kemi prej atyre që nuk mund të bëjnë deklaratë publike se babai i tij asnjëherë nuk ka luftuar kundër vendit të tij? A kemi nga ata që nuk e dinë se po nuk deshën ushtrinë e tyre do të jenë të detyruar të duan ushtrinë e dikujt tjetër?

Kurse burrat që janë pengë në Hagë vijnë nëpër luftë. Ata më mirë se askush tjetër e dinë çmimin e jetës. E nuk janë fajtorë ata pse lufta që dikujt i jep lavdi, turpin ua lë të tjerëve. Prandaj ata si dje edhe sot e dinë kush është armiku. E njohin mirë atë ashtu siç njohin edhe veten, prandaj edhe nuk rrezikojnë edhe po të futen në beteja të panumërta. E dinë mirë lojën e luftës ata. Sepse para se ta fillonin luftën kundër Serbisë e kishin fituar atë. Edhe në Hagë nuk i kanë marrë, por kanë shkuar sapo i kanë thirrur. Dhe e kanë bërë këtë se atë ditë që janë nisur për atje e kanë fituar gjyqin. Nuk kanë shkuar me shpresë të dalin të pafajshëm, por kanë shkuar me bindjen se janë të pafajshëm. Unë i pres të vijnë. A vijnë shpejtë nuk e di. Që vijnë krenar e di. **(Fund)**



Hovenieri kërkon lirimin e zëvendës drejtorit të Policisë së Kosovës

PRISHTINE, 18 PRILL - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, kërkoj që autoritetet serbe ta lirojnë zëvendës drejtorin e Policisë së Kosovës, Dejan Janković, i cili u ndalua një ditë më parë në pikëkalimin kufitar të Jarinjës, që lidh Kosovën me Serbinë.

Pas takimit të rregullt me presidentin e Kosovës, Vjosa Osmani, Hovenieri tha për mediet se me të parën e shtetit folën edhe për ngjarjet e 17 prillit kur, sipas autoriteteve në Kosovë, Serbia ndaloi mbi 1 400 kosovarë teksa po kalonin transit nëpër Serbi.

Në mesin e të ndaluarve ishin edhe dhjetë zyrtarë policorë. Autoritetet thanë se nëntë zyrtarë policorë janë liruar, ndërkaq ndaj Jankovićit, Serbia ka caktuar masën e paraburgimit prej 48 orësh nën

akuzën për prishje të rendit kushtetues të Serbisë. "Ne jemi të shqetësuar sepse atë e njohim tash e disa vjet për investimin e kohës dhe energjisë për komunitetin serb dhe policinë, duke ndihmuar dhe siguruar integritetin e suksesshëm të forcës policore që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës pavarësisht etnisë së tyre. Ai ka pasur rol të rëndësishëm në sigurimin e ndjeshmërisë që lidhet me komunitetin serb dhe që adresohen nga Policia e Kosovës. Për shembull, ai ka luajtur rol edhe në mbikëqyrjen e njësisë që ofron mbrojtje për monumentet e trashëgimisë kulturore, përfshirë edhe manastiret ortodokse serbe, në një mënyrë të fuqishme, kuptimplotë dhe efektive. Ne jemi shumë të shqetësuar dhe shpresojmë që ai të lirohet",



shtoi diplomati amerikan. Thirrje për lirim të Jankovićit dhe ulje të tensioneve bëri edhe ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, duke e cilësuar të "papranueshëm" ndalimin e zyrtarit policor. Kosova ka akuzuar Serbinë se me veprimet e fundit ka kryer

shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe ka shkelur marrëveshjet e arritura në dialog, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Edhe blloku evropian një ditë më parë tha se Serbia, me ndalimin e udhëtarëve dhe autobusëve nga Kosova, në kufijtë e

saj me Hungarinë dhe Kroacinë, ka shkelur Marrëveshjen për lëvizjen e lirë. Hovenieri tha se ShBA-ja pajtohet me vlerësimin e BE-së për këtë çështje, duke shtuar se Uashingtoni, si mbështetës i procesit të dialogut, pret që të gjitha marrëveshjet e arritura në Bruksel të respektohen dhe zbatohen.

Kosova ka thënë se ndalimi dhe "maltretimi" i shtetasve të Kosovës që po kalonin nëpër Serbi u bë "në shenjë hakmarrjeje" pasi më 16 prill Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës mbështeti anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Serbia ka thënë se do të punojë që Kosova të mos pranohet në këtë organizatë gjatë mbledhjes së Këshillit të ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës më 16 maj.

Edhe një raund i pasuksesshëm në Bruksel për dinarin

PRISHTINE, 18 PRILL - Ka përfunduar pa ndonjë marrëveshje të enjten edhe raundi i ri dhe i katërt në përgjithësi në mes të kryenegociatorit të Kosovës dhe atij të Serbisë, ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, për çështjen e dinarit serb, përdorimi i të cilit u ndalua në Kosovë në muajin shkurt.

Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, tha pas takimit se pala serbe nuk ka ardhur me ide se si të trajtohet propozimi fillestar i të dërguarit të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak, "por ka paraqitur propozimin e vet". Kryenegociatori i Serbisë, Petar Petković, tha se Beogradi "bëri gjithçka për të gjetur një zgjidhje". "Ne dolëm me një propozim konstruktiv dhe ai propozim u vlerësua nga Brukseli, pra Lajčak, si një bazë shumë e mirë për vazhdimin e bisedimeve", tha ai.



Duke iu drejtuar medieve pas takimit, Petković bëri me dije se në javën e ardhshme do të mbahet një raund tjetër bisedimesh. "Në anën tjetër, kemi Prishtinën, e cila ka ardhur në Bruksel pa komentuar idetë e BE-së dhe kjo tregon qartë se pala tjetër nuk dëshiron të pajtohet për asgjë", sipas tij. I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi,

Miroslav Lajčak, u takua ndaras me kryenegociatorin Petković dhe me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi. Për dallim nga takimet e kaluara, të enjten nuk kishte takim trepalësh mes tyre. Lajčaku kishte thënë ditë më parë se në takimin e kësaj të enjte synohej gjetja "e një zgjidhjeje të përkohshme" për personat e prekur nga vendimi i

Bankës Qendrore të Kosovës. Më 1 shkurt në Kosovë hyri në fuqi një rregullore e BQK-së e cila ndalon përdorimin e dinarit serb për kryerjen e pagesave. Për çështjen e dinarit serb, delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë kanë zhvilluar edhe takime në të kaluarën, të cilat kanë përfunduar pa ndonjë përparim. Raundi i fundit i bisedimeve për këtë çështje mes kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe atij të Serbisë, Petar Petković, është zhvilluar më 4 prill. Pas atij takimi, Bislimi deklaroi se palët ende kanë "dallime të mëdha", ndërkaq Petković tha se Kosova nuk tregoi "vullnet të mjaftueshëm" për të arritur një marrëveshje për këtë çështje. Në raundet paraprake të dialogut, kryenegociatorët kanë diskutuar për propozimet e paraqitura nga ta për çështjen e

dinarit serb. Bislimi ka deklaruar se propozimi i Kosovës është "konstruktiv" që, sipas tij, mundëson që mbështetja financiare "të shkojë te përdoruesit finalë, por pa u lënduar në asnjë moment rregullorja e BQK-së" dhe legjislacioni i Kosovës. Ndërkaq, Petković e ka cilësuar propozimin serb për dinarin si "të balancuar", i cili, sipas tij, ka për bazë "interesat e popullit serb në Kosovë". Me rregulloren e BQK-së, euroja është caktuar si valuta e vetme në Kosovë për kryerjen e pagesave. Hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje ka zemëruar Serbinë, e cila përmes buxhetit të saj shtetëror u dërgon ndihmë financiare serbëve që jetojnë në Kosovë. Komuniteti ndërkombëtar i ka kërkuar Kosovës ta pezullojë rregulloren në mënyrë që t'u jepet kohë qytetarëve të përshatën me praktikën e re.

Një serb në Zveçan thotë se u sulmua për shkak se bashkëpunon me shqiptarë

ZVEÇAN, 18 PRILL - Në oborrin e një shtëpie në komunën e Zveçanit është hedhur një mjet shpërthyes, në orët e hershme të 18 prillit, me ç'rast janë shaktuar dëme materiale. "Dyshohet se shpërthimi është shkaktuar nga një granatë dore", ka konfirmuar zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, në një prononcim për "Radio Evropa e Lirë". Ngjarja ka ndodhur në fshatin Zherovnicë. Dragan Mllagjović konfirmoi për "Radio Evropa e Lirë" se një bombë u hodh në oborrin e shtëpisë së tij në orën 02:34 të 18 prillit. Mllagjović është distributor i produkteve në veri të Kosovës i

kompanisë "Devolli Vita Corporation" nga Peja. Ai tha se beson se arsyeja e sulmit ishte se, pasi ka shpërndarë produkte të qumështit të kompanisë nga Peja, ka nisur shpërndarjen në veri edhe të mishit të kësaj kompanie. "Kur dola nga shtëpia rreth orës 06:00 me djalin tim pashë që xhamat e shtëpisë që ishin thyer, dyert, fasada dhe furgoni im ishin dëmtuar. Kam kontaktuar policinë e cila ka ardhur të kryejë hetime", tha ai, duke shtuar se në dhjetorin e vitit të kaluar ka pasur një problem në aplikacionin e mesazheve "Telegram". "Radio Evropa e Lirë" mëson se grupe në "Telegram" e kishin cilësuar atë si "tradhtar" dhe

ishite publikuar fotografia e tij së bashku me 12 serbë të tjerë ku ishte shkruar mesazhi se ata ishin "mbeturinat më të mëdha të shoqërisë". "Kompania e djalit tim nisi shpërndarjen e qumështit dhe kosit nga Peja. Para një muaji kemi nisur shpërndarjen e mishit nga Peja, i cili është i cilësisë së lartë dhe të cilin restorantet dhe dyqanet kanë filluar ta blejnë. Unë dyshoj, dhe i thashë policisë, se arsyeja për gjithçka [shpërthimin] është se ne punojmë me ato kompani", tha Mllagjović. Ai shtoi se po i bën konkurrencë dikujt që merret me këtë biznes në 25 vitet e fundit. "Dhe tash dikujt po i pengojmë dhe duan



të na trembin me bomba, në mënyrë që të na ndalojnë", u shpreh Mllagjović, që tha se do të vazhdojë të punojë, pasi biznesi i tij është i rregullt dhe i ligjshëm. "I gjithë veriu punon

me shqiptarë. Pse mos ta bëj edhe unë, sepse jam i vetmi distributor që kam marrë përsipër disa produkte dhe tani kam probleme. Pse mos të punoj dhe të punësoj dikë", u shpreh ai.

Kërkohet interpelancë në parlamentin e Zvicrës pas stërzgjatjes së procedurave kundër ish-presidentit Thaçi nga Specialja

PRISHTINË, 18 PRILL - Miku i Kosovës, deputeti i Parlamentit të Zvicrës, Reto Nause, i cili është edhe Co-president i Grupit Parlamentar të Miqësisë Zvicër - Kosovë, ka dorëzuar në parlamentin e këtij shteti një kërkesë për interpelancë, për të marrë përgjigje nga qeveria zvicerane në lidhje me zhvillimet e fundit në Kosovë dhe procedurat e gjata të Gjykatës Speciale në raport me ish-presidentin Hashim Thaçi.

Kjo nismë, që është iniciuar nga drejtori i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, pos Retos, ka marrë mbështetjen edhe nga shtatë parlamentarë të tjerë zviceranë: Cedric Wermuth (PS), Philippe Nantermod (PLR/FDP), Jacqueline De Quattro (PLR/FDP), Maitre Vincent (Centre /Di mitte), Andreas Mayer (Die Mitte), Leo Muller (Die Mitte), Marc Jost (PEV), të gjithë nënshkruar në këtë interpelancë, ku kërkohet

nga qeveria zvicerane qëndrim në lidhje me 5 pyetje: 1. Si vlerësohet gjendja e sigurisë, veçanërisht në veri të Kosovës?; 2. Çfarë kontributi po jep Zvicra për sigurimin e stabilitetit politik dhe kundërveprimit të ngjarjeve të reja ushtarake?; 3. Si i vlerëson Këshilli Federal deklaratat e fundit të presidentit serb që nxisin frikën për një konflikt të armatosur?; 4. Në këtë sfond, çfarë ndikimi kanë në stabilitetin në Kosovë procedurat e gjata dhe të ngadalta ligjore kundër ish-presidentit Thaçi?; A është në dijeni Këshilli Federal për rezolutën e organizatës jo qeveritare "Zëri perëndimor i Kosovës", i cili është nënshkruar nga 30 deputetë federalë? dhe 5. Ku janë negociatat e marrëveshjes së tregtisë së lirë EFTA - Kosovë, të cilat mund të kontribuojnë në stabilitetin ekonomik?

Në sesionin e ardhshëm parlamentar, nga 27 maj deri më 14 qershor, qeveria zvicerane



pritet të japë përgjigje në lidhje me këtë interpelancë.

Veprimtari Sali Bislimi ka theksuar se rreth 250 000 shqiptarë nga Kosova jetojnë në Zvicër. "Kemi një diasporë shumë të fortë. Nëse

situata në Kosovë del jashtë kontrollit ose nëse konfliktet vazhdojnë të intensifikohen, kjo do të ketë një ndikim drejtpërdrejt të dukshëm dhe të gjerë në Zvicër. Prandaj është në interesin e

Zvicrës të japë një kontribut të drejtpërdrejtë për një situatë të qëndrueshme sigurie dhe stabilitet politik", ka theksuar Sali Bislimi, i cili është shtytës i kësaj nisme.

Serbia mohon se i ndaloi qytetarët e Kosovës në kufi me Kroacinë dhe Hungarinë

PRISHTINË, 18 PRILL - Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë i ka mohuar akuzat e autoriteteve të Kosovës se ka ndaluar autobusë me udhëtarë kosovarë në kufijtë e saj me Kroacinë dhe Hungarinë të mërkurën. "Këto pretendime janë të pabaza dhe policia nuk ka ndaluar askënd, as penguar hyrjen dhe kalimin e çdo qytetari nga territori i 'Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë'", tha Ministria serbe në një komunikatë. "Po forcohet kontrolli i të gjithë pasagjerëve në pikat kufitare dhe po kryhen kontrolle të sigurisë me qëllim të sigurisë dhe sigurisë më të madhe të qytetarëve, që mund të shkaktojë një qëndrim më të gjatë në pikën kufitare", ka theksuar kjo ministri.

Autoritetet e Kosovës thanë të mërkurën herët se Serbia ka ndaluar autobusë me udhëtarë nga Kosova në kufijtë me Kroacinë



dhe Hungarinë në "shenjë hakmarrjeje ndaj mbështetjes nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë". Ato u bënë thirrje qytetarëve të Kosovës ta shmangin "me çdo kusht" kalimin nëpër Serbi, shtet në të cilin që nga mesnata kosovarëve u është vështirësuar qarkullimi.

Bashkimi Evropian tha se po e ndjek nga afër gjendjen dhe se Serbia është duke e shkelur marrëveshjen për lirinë e lëvizjes duke ndaluar udhëtarët kosovarë. Por, ministria serbe tha më vonë se qytetarëve të Kosovës u "lejohej hyrja e papenguar dhe refuzon me forcë insinuatën se u ndalohet hyrja për shkak të posedimit të dokumenteve të lëshuara nga

institucionet e përkohshme në Prishtinë".

Megjithatë, Ibrahim Aliu, pronar i kompanisë turistike "Rinor Travel", i tha "Radios Evropa e Lirë" se që nga mëngjesi i së mërkurës një autobus i kompanisë së tij është ndaluar në territorin serb pas kalimit të kufirit të Hungarisë. Autobusi po udhëtonte nga Zvicra për në Kosovë. "Sipas shoferëve, me të cilët jam në kontakt, [autoritetet serbe] kanë marrë dy udhëtarë dhe dokumentet e autobusit", tha Aliu.

Paraprakisht sekretari i Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Beograd, Fatmir Haxholli, përmes një postimi në "Facebook" tha se në Batrovç janë ndaluar të paktën katër autobusë, me "mbi 300 udhëtarë nga Kosova".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e cilësoi si "shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut" ndalimin në territorin e Serbisë të shtetasve të

Kosovës, të cilët "janë privuar nga ushqimi dhe ilaçet".

Më 16 prill në Asambleenë Parlamentare u miratua rekomandimi për pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Çështja tani do të dërgohet te Këshilli i Ministrave, që takohet në maj, organ që jep përgjigjen përfundimtare për anëtarësimin e një shteti në këtë organizatë. Serbia kundërshton anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Dačić, deklaroi pas votimit se shteti i tij do ta vazhdojë luftën "me të gjitha forcat" që vendimi të mos miratohet në mbledhjen e ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës më 16 maj. Edhe në të kaluarën qytetarët e Kosovës që kalonin përmes Serbisë kanë hasur në probleme, me disa prej tyre që janë arrestuar nga autoritetet serbe, me dyshime për krime lufte.

Kurti bën homazhe në Ditën e Dëshmorëve të kryeqytetit

PRISHTINË, 18 PRILL - Me rastin e Ditës së Dëshmorëve të komunës së Prishtinës, kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në lagjen Velania në Prishtinë.

I shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, kryeministri tha se i kujtojnë sot dëshmorët dhe martirët e Marecit, 27 dëshmorë dhe 16

martirë që ranë heroikisht para 25 vjetëve.

Ai theksoi se nga sot e katër ditët në vijim përkujtojmë masakrën më të madhe në komunën e Prishtinës, e cila ka ndodhur në fshatin Makoc, ku janë vrarë 115 civilë, në mesin e të cilëve shumë pleq dhe fëmijë. "Njëkohësisht sot i kujtojmë dëshmorët dhe martirët e Marecit - janë 27 dëshmorë dhe 16 martirë që ranë heroikisht para 25 vjetëve. Gjithashtu nga sot e në katër ditët në vijim përkujtojmë masakrën më të

madhe në komunën e Prishtinës, e cila ka ndodhur në fshatin Makoc, ku janë vrarë 115 civilë, në mesin e të cilëve shumë pleq dhe fëmijë. Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe martirëve që ranë në rrugën tonë të përbashkët për lirinë e Kosovës e çlirimin e popullit!", ka thënë Kurti.

Të pranishëm në këto homazhe ishin edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mefail Bajqinovci, Salih Zyba, Enver Dugolli dhe Driton Hyseni.



KESCO po viziton bizneset anekënd vendit

PRISHTINË, 18 PRILL - KESCO ka filluar takimet me bizneset e Kosovës në secilin vendbanim nëpër industri, biznese të mesme e të vogla të vendit tonë.

Departamenti i Përkujdesjes për Konsumatorë ka vizituar më shumë se 20 biznese të ndryshme deri më tani dhe do t'i vazhdojë takimet me pronarët e bizneseve në ditët në vijim. Këto takime kanë për qëllim njohjen nga afër me kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve biznesorë në Kosovë në raport me KESCO-n, si furnizues i shërbimit universal të energjisë elektrike. Gjithashtu, synimi i kompanisë është ta përmirësojë secilin

shërbim për konsumatorët tanë, qoftë për ata shtëpiakë ose komercialë.

Marrë parasysh rolin e rëndësishëm që bizneset kanë për zhvillimin ekonomik të vendit, KESCO angazhohet t'i trajtojë bizneset me prioritet të lartë, duke u ofruar shërbime kualitative dhe të qëndrueshme të energjisë elektrike.

KESCO tashmë ka krijuar linja të veçanta për konsumatorët biznesorë në mënyrë që t'i kryejnë të gjitha procedurat që u nevojiten pa pasur nevojë të presin në radhë.

Një linjë e veçantë me dy analiste për përkujdes të konsumatorëve është në pikën

e re të KESCO Premium Center.

Refki Hoxha, pronar i kompanisë "Renelual Tahiri" në Prizren, ka thënë se janë tejet të kënaqur me shërbimet që KESCO ua ofron. "Ne jemi shumë të kënaqur me KESCO-n, sidomos kur na lajmëron një ditë përpara nëse do të ketë punime të planifikuara në zonën tonë", ka thënë ai.

Gjithashtu, edhe pronari i fabrikës "Frutex" në Suharekë, Shaqir Palushi, ka thënë se paralajmërimet e KESCO-s për punimet në rrjet që realizohen nga KEDS, janë të domosdoshme për bizneset në mënyrë që ta planifikojnë prodhimin.



Bizneset e painformuara për ekzistimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 PRILL - Lëvizja Fol, me mbështetjen e aktivitetit të USAID-it për integritet të komunave të Kosovës, ka mbajtur tryezën e diskutimit në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat, ku u shpalosën gjetjet e raportit të Lëvizjes Fol të titulluar: "Gjetjet e anketës mbi të kuptuarit dhe perceptimin e sinjalizimit nga punonjësit e sektorit privat".

Qëllimi i këtij raporti ishte të vlerësohet niveli i informimit dhe perceptimi i subjekteve të sektorit privat për mekanizmin e sinjalizimit dhe se sa po zbatohet realisht ky mekanizëm në praktikë.

Drejtoresha e Lëvizjes Fol, Mexhide Demolli-Nimani, ka falënderuar pjesëmarrësit dhe ka shpjeguar se kjo anketë vlerësoi shkallën në të cilën subjektet e sektorit privat janë të informuara për mekanizmin e sinjalizimit si dhe nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat.

Përfaqësuesi i aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, Stephen Carpenter, ka thënë se gjetjet e Lëvizjes Fol tregojnë vlerën dhe nevojën urgjente për



përmirësimin e kësaj gjendjeje përmes trajnimeve.

Sipas Carpenterit, përderisa sot ndajmë përvojat dhe strategjitë e ndryshme, duhet të përqendrohemi më shumë për përmirësimin e kësaj fushe.

Hulumtuesja e lartë në Lëvizjen Fol, Albana Hasani, ka prezantuar gjetjet e këtij raporti. Përveç kësaj, ajo ka theksuar se për Fol-in gjetjet ishin rezultate befusuese, meqë është pritur që përqindja e bizneseve të painformuara në lidhje me sinjalizimin ka me qenë më e lartë, megjithatë, sipas saj, edhe këto shifra theksojnë domosdoshmërinë e ndërmarjes së iniciativave për

rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të bizneseve lidhur me këtë ligj.

Drejtori i Departamentit për Planifikim Strategjik në Inspektoratin e Punës, Vesel Zhinipotoku, ka bërë me dije se këtë vit thuajse është filluar me një qasje më pozitive që të gjitha subjektet ekonomike ta caktojnë zyrтарin përgjegjës për sinjalizim. Sipas tij, ka subjekte që paraprakisht i kanë caktuar personat përgjegjës, mirëpo sa janë efektive lë për të dëshiruar. Gjithashtu, Zhinipotoku, ka theksuar se masa ndëshkimore nuk kanë shqiptuar për subjektet që nuk i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës, përveç 1 rasti, në

mënyrë që të punohet në preventivë dhe jo në ndëshkim.

Ushtruesi i udhëheqësit të Divizionit për Sinjalizim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Milot Shala, ka thënë se gjendja është më e mirë në sektorin publik sesa në atë privat. Ai ka thënë se agjencia është shumë e gatshme për të bashkëpunuar, sidomos në vetëdijësim dhe në trajnime.

Drejtoresha e Aleancës Kosovare të Bizneseve, Lumnije Ajdini, ka thënë se situata reale nga bizneset është shumë më keq sesa që po e diskutojmë këtu. Bizneset nuk kanë qenë aspak të informuara as nga ministria as nga institucionet e tjera

relevante. Sipas tij, ky mekanizëm është shumë i vlefshëm sepse ka favore që e mbrojnë imazhin e kompanive në Kosovë. Gjithashtu, Ajdini ka thënë se numri i inspektorëve nuk është i mjaftueshëm për ta mbuluar këtë fushë.

Udhëheqësi i Departamentit Ligjor në Kompaninë "Liridoni", Ngazhnjim Lajçi, ka thënë se mbetet sfidues zbatimi i këtij mekanizmi, sidomos kur ka të bëjë me ruajtjen e konfidencialitetit. Lajçi ka thënë se po vërehet në terren rritja e numrit të inspektorëve dhe, sipas tij, kompania në të cilën punon ai ka pasur vazhdimisht inspektime nga ky institucion.

Delegacioni i lartë i BQK-së takon përfaqësues të Departamentit të Thesarit të ShBA-së, diskutohet për forcimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 18 PRILL - Një delegacion i nivelit të lartë të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, zhvilloi diskutime konstruktive me zëvendësndihmësekretarin (DAS) e Departamentit të Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Luyen Tran dhe ekipin e tij të Zyrës së Asistencës Teknike (OTA) në Uashington.

Diskutimet kishin për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për

ngritjen e kapaciteteve të BQK-së.

Në takimin me Departamentin amerikan të Thesarit, guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen e sigurtë për ndihmën e çmuar teknike të ofruar nga OTA-ja dhe rolin kryesor në mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës kritike.

Kjo përfshin mbështetjen në zhvillimin e Sistemit Qendror Depozitar të Letrave me Vlerë, krijimin e linjave të likuiditetit, si dhe bashkëpunimin e

suksesshëm në shumë projekte të tjera për mbikëqyrjen bankare dhe sigurimeve, si dhe në kornizën e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ndër të tjera.

Gjithashtu, u diskutuan mundësitë e reja të asistencave teknike dhe bashkëpunimit, me qëllim të forcimit të partneritetit me Departamentin e Thesarit të ShBA-së.

Këto angazhime nënvizojnë përkushtimin e BQK-së për të kultivuar partneritet të qëndrueshëm me aktorët



kryesorë ndërkombëtarë, duke fuqizuar më tej misionin e institucionit për promovimin e

stabilitetit financiar dhe zhvillimin të qëndrueshëm të vendit.

Nata që ndryshoi ekuilibrat në Lindjen e Mesme

Nga beteja e madhe e natës, kur Irani sulmoi Izraelin, mund të lindë embrioni i një ideje krejt të ndryshme mbi Lindjen e Mesme. Si dhe të një paradigme krejt të ndryshme të sigurisë globale. Sepse, Izraeli ia doli që të ndalte furinë e raketave iraniane, jo vetëm prej mbrojtjes së vet hapësinore. E bëri mbi të gjitha falë aleancës me vendet sunnite, e ndërmjetësuar prej SHBA. Ia doli falë marrëveshjes së quajtur Mead (Middle East Air Defence), një marrëveshje top secret, e cila bashkon informacionet e radarëve, si dhe koordinon goditjet e baterive tokë-ajër të shumë vendeve arabe. Natën e gjatë të dronëve, bota u bë dëshmitare e fuqisë së një koalicioni. Izraeli, bashkë me SHBA dhe disa vende sunnite, u

mbrojtën në një mënyrë që nuk ka precedentë. Ky koalicion i paprecedentë ka kapërcyer një provë zjarri të jashtëzakonshme, dhe tani po bëhet pikë referimi për skenarët e ardhshëm: një model tjetër për marrëdhëniet mes Izraelit dhe monarkive të Gjirit. Aleanca mes Moskës dhe Teheranit, që u shpërfaq në luftën e Ukrainës po bën që të rritet shumë në cilës armatimi i Iranit, edhe falë ardhjes së armatimeve ruse të gjeneratës së fundit. Mbështetja financiare e Kinës dhe armët e furnizuara nga Rusia kanë shtuar frikën se Irani mund të shfrytëzojë momentin për të shtuar goditjet kundër armiqve të vjetër sunitë. Dhe pamjet e raketave që ndezën qiejt e Amanit, Bagdadit dhe



Beirutit, kanë shkaktuar frikë në të gjitha kryeqytetet e rajonit, për atë që mund të bëjë Irani. Nuk janë trembur vetëm Izraelitët. Prania e interceptorëve

francezë dhe britanikë në betejën e natës, është dëshmi se frika është përhapur edhe në Evropë. Ja pra, që krejt papritur një betejë e tillë ka ndryshuar të gjithë

ekuilibrat e forcës në rajon dhe jo vetëm. Pjesa më e madhe e botës është bashkuar tashmë, duke identifikuar rrezikun e madh: Iranin. / bota.al

Nga Apple tek Tesla, kjo është “nafta” e kohëve moderne

Rritja e tregut të aksioneve në SHBA në vitin 2023 erdhi për shkak të shtatë kompanive më të mëdha të teknologjisë: Apple, Microsoft, Google-Alphabet, Meta, Amazon, Nvidia dhe Tesla. Në themel të suksesit të tyre, është pasuria më e çmuar e kohës sonë: të dhënat që ne gjenerojmë kur kemi kontakt me një pajisje të lidhur online.

Ugo MATTEI

Dihet që gazetaret e printuara janë në krizë, sepse gjithnjë e më shumë njerëz, veçanërisht të rinjtë, i marrin informacionet e tyre në internet. Dihet gjithashtu se gjithçka që ndodh në internet, ashtu si një diamant, është e përjetshme, sepse gjurmët e të gjitha kontakteve tona mbeten përgjithmonë të disponueshme për ata që e dinë, dhe duan t'i përdorin. Këto gjurmë të pashlyeshme përbëjnë arsyen kryesore, për suksesin e jashtëzakonshëm ekonomik të shtatë gjigandëve të tregut të teknologjisë – Apple, Microsoft, Google-Alphabet, Meta, Amazon, Nvidia dhe Tesla – , të cilat kanë akumuluar të gjithë rritjen e kapitalizimit të aksioneve amerikane në vitin 2023. Ky përqendrim i pasurisë shpjegohet përmes metaforës së të dhënave tona, si ‘nafta e re’ e një industrie kontrolli që shpërblen ata që dinë më mirë të nxjerrin të dhëna të përpunueshme nga sjelljet tona, për të parashikuar të ardhmen. Sot, katër vjet pas fillimit të pandemisë, duket e pamundur të imagjinohet se si mund të jetojmë pa programe video-konferencash si Zoom ose Meet, ose pa qenë në gjendje të kemi çdo mall, përfshirë ushqimin, të dorëzuar


në derën e shtëpisë. Të njëjtin mosbesim shfaqnin vite më parë vajzat e mia adoleshente kur u tregova se dikur mund të takoheshim në shesh duke lënë takime fikse, pa kryer një sërë telefonatash. Kjo vetëm katër vjet pas Covid-it dhe pak më shumë se një vit pas përhapjes së ChatGpt, sistemi i inteligjencës artificiale që po bëhet i pazëvendësueshëm. Natyrisht, këto mrekulli teknologjike fshehin një anë të errët, për të cilën është mirë të kemi kujdes, e cila varion nga energjia intensive dhe shfrytëzimi social deri te survejimi masiv, deri te marrja e të dhënave personale në mënyrat më të paimagjinueshme, për shembull kur hipim, zbresim, bisedojmë ose zgjedhim destinacionin në një makinë të gjeneratës së fundit. Lënia e gjurmëve të pashlyeshme, nga kalimi i thjeshtë e deri tek ajo që themi në një bisedë pranë celularit, mund të krijojë një fenomen të çuditshëm autocensure. Mbledhjet e komisionit politik, ekonomiko-organizativ apo të konkurrencës, apo mesimet online nuk mund të jenë plotësisht falas. Dikur thuhej verba volant, scripta manent. Në internet, omnia manent, gjithçka mbetet: fjalët, shkrimet, veprimet. Në kontekstin tonë të



ndërmjetësuar tërësisht nga teknologjia dixhitale, dallimi i të vërtetës nga gënjeshtër bëhet shumë kompleks. Para disa javësh, për eksperiment, një doktorant më kërkoi t'i dërgoja një faqe të shkurtër në italisht, me katër-pesë mendime për një temë që më caktoi. Disa orë më vonë ai më dërgoi një video, në të cilën unë e recitoja atë tekst në gjermanisht, një gjuhë që nuk e di. Videoja u ‘filmua’ në një zyrë të bukur imagjinare dhe unë lëviza gojën në një përputhje me gjuhën gjermane që flisja. Ishte e pamundur të kuptohej që ishte e rreme. Një ditë më pas, erdhi një njoftim nga dekani i fakultetit tim në San Francisko, ku na informonte ne profesorët se programi i inteligjencës artificiale të Lexis Nexis (baza e të dhënave më e rëndësishme e jurisprudencës dhe doktrinës në Shtetet e Bashkuara) kishte rënë në “vesin” e shpikjes së çështjeve. Inteligjenca e Lexis, ashtu si një

avokat i pandershëm, në vend që të mos i përgjigjej klientit, e shpikte përgjigjen në një mënyrë shumë të vështirë për t'u zbuluar dhe të pashpjegueshme për programuesit, ashtu siç është e vështirë të zbulosh studentin që e “ndihmon” veten të shkruajë kapituj të tërë të tezës nga ChatGPT. Së fundi, që nga viti 2022 startup-i izraelit Toka, në pronësi të ish-kryeministrit Ehud Barak, ka tregtuar (dhe transferuar te qeveritë dhe shërbimet sekrete) programe të afta për të hyrë në kamerat e vëzhgimit, duke futur imazhe që u mundësojnë atyre të fusin edhe njerëz që as nuk janë as aty. Prandaj, në botën tonë virtuale është shumë e vështirë të dallosh të rremen nga e vërteta. Kjo vështirësi është e rrezikshme (mendoni pasojat e një videoje të rreme të Putinut që shpall një sulm bërthamor) dhe sigurisht që do të bëhet gjithnjë e më shumë, me përparimin teknologjik dhe sikur makina të bëhet më

inteligjente se programuesi i saj. Ja pse masat legislative që përpiqen të rregullojnë këtë problem të paprecedentë na bëjnë të buzëqeshim me naivitetin e tyre, në mos dyshimin e kompleteve, për rreziqet që i shkaktojnë demokracisë. GDPR (Rregullorja e Përgjithshme e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të 2016), për shembull, i jep përdoruesit të drejtën për të marrë shpjegime në terma të kuptueshme të mënyrës se si cilën makina përpunon të dhënat e tij. Në realitet, as programuesi nuk e di. Kohët e fundit, përsëri në Evropë, Akti i Shërbimit Dixhital i vitit 2022, i cili hyri në fuqi më 17 shkurt, jo vetëm që përsërit këtë parim, por u jep platformave një lloj detyre për të dalluar lajmet e rreme nga lajmet reale, me një gjobë të rëndë (deri në 16% të xhiros). Kjo gjeneron një fuqi të jashtëzakonshme censurimi pikërisht në duart e atyre ‘7 madhështorëve’, që do të donin të kufizonin fuqinë e tyre të tepërt, të cilët do të kenë detyrimin për të publikuar vetëm lajmet që vijnë nga mediat kryesore, duke përjashtuar si të rremë çdo informacion të ndryshëm nga ai që pushtetet duan të dalin. Kjo ka ndodhur në Itali, ndër të tjera, edhe për televizionin me përhapje kombëtare Byoblu. Që e gjithë kjo po ndodh ndërkohë që ne presim vendimin për çështjen Assange, një gazetar që rrezikon disa dënime të përjetshme për shkak se ka vënë në dispozicion të publikut një platformë të ‘të vërtetës’, tingëllon më e pakta shqetësuese. / Forbes – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

5 fitore për 7 muaj, Mersim Zeqiri synon t'i fitojë dy tituj në fshatin e tij Garanë



CYRIL, 18 PRILL - Trojet shqiptare kanë nxjerrë njerëz të suksesshëm dhe të arrirë në fusha të ndryshme. Pa diskutim, sportistët ishin ata që i bënë më së shumti krenarë shqiptarët. E një storje suksesi në vete është edhe Mersim Zeqiri. Boksieri shqiptar nga Maqedonia e Veriut po i mahnit të gjithë me aftësitë e tij në boks. Ndonëse pjesën më të madhe të karrierës e kaloi në një tjetër sport luftarak, së fundmi ai është bërë sensacion në boksion profesionist, ku është ende i pamposhtur. Zeqiri tregon se që nga fëmijëria i kishte pëlqyer sportet luftarake dhe se gjithçka kishte nisur duke i shikuar filmat aksion, ku zhvilloheshin sportet luftarake me plot adrenalinë. “Jam lind dhe jam rrit në fshatin Garanë të Kërçovës. Përpara i kemi pasur kasetat që kanë qenë me Bruce Lee, me Rocky, me Van Dame dhe jemi inspiruar prej tyre. Kemi dashur të bëheshim si ta. Kështu ka lindur dashuria ndaj këtij sporti. Nga mosha 11-vjeçare ia kam nisur aktivisht, kam shkuar edhe në klub, kam shkuar në Klubin Frenkendorf, është në Baselland, aty kam nisur me kick-boks. Kam pasur luftëra me amatorë, kam qenë në atë pjesën e kick-boksit, që quhet

full-kontakt. I kam pasur mbi 80 luftëra në amatorë, kam pasur sukses”, thotë fillimisht boksieri shqiptar në një intervistë me TV Syri në Zvicër.

Beqiri është marrë për një kohë të gjatë me kick-boks, por pak kohë më parë hoqi dorë nga ky sport pasi mbeti i dëshpëruar. “Puna e kick-boksit ka qenë prej fëmijërisë, prej moshës 5-6 vjeç. Menaxhmentin nuk e kam pas në kick-boks, kam qenë i dëshpëruar, prandaj edhe nuk ka ecur si duhet, nuk ka qenë mirë e menaxhuar”, vazhdoi ai. “Nuk po më mungon kick-boksi, sportin nuk e kam lënë, veç i kam lënë këmbët, tash po punoj veç me duar. Tjetër gjë është krejt njëjtë”, shton ai duke e bërë krahasimin mes dy disiplinave të këtij sporti luftarak.

Mersim Zeqiri nuk mund ta imagjinonte një fillim aq impresionues në boksion profesionist. Ai i ka regjistruar pesë fitore në po aq meçe në shtatë muajt e fundit, pra për një periudhë jashtëzakonisht të shkurtër. Dhe për këtë i është falënderues menaxherit, promotorit dhe “match-makerit” të njohur shqiptar Avdyll Salihu. “Unë kam qenë i dëshpëruar me kick-boks, isha pa menaxher... e

Avdyll Salihu ka qenë pika që më ka kthyer. E falënderoj shumë. Në boksion profesionist kemi treguar me Avdyll Salihun se çka është e mundur për shtatë muajt që të boksoj për dy tituj internacionalë, që njihen në krejt botën, UBO dhe UBF”, shprehet ai. “Në boksion profesional është krejt ndryshe. Aty e kam në krahë Avdyll Salihun, i cili është menaxheri im personal dhe promoteri im. Ai ndan shumë kohë me mua dhe për mua dhe po shihen edhe rezultatet. I kam 5 fitore në 5 meçe brenda shtatë muajsh. Është një sukses shumë i madh brenda një periudhe të shkurtër”, shprehet tutje boksieri shqiptar nga Maqedonia e Veriut. Sa iu përket ndjenjave që ia sjell ringu, ai thotë se janë të papërshkrueshme dhe të pashpjegueshme për ata që s’e kanë provuar ringun, njëjtë si t’i tregosh dikujt që s’është bërë ende prind se si është të kesh fëmijë. Mersim Zeqiri ka boksuar edhe në të kaluarën në Maqedoninë e Veriut, por më 20 korrik të këtij viti ai do ta zhvillojë një meç të veçantë dhe mjaft emocionues. Ai do të zbrësë në ring në fshatin e tij dhe mezi po e pret këtë meç, i cili mund t’ia sjellë dy breza (rripa) të artë.

“Federata UBO është Federatë e Danimarkës, e UBF është e Amerikës. Na kanë mundur Internacional me boksu për dy tituj. Bashkë me stafin kemi vendos që kjo ngjarje ‘Garana Fight Night 20 Korrik 2024’ të ndodhë në fshatin tim ku kam lindur, në fshatin Garanë, është një fshat i vogël, është shumë i bukur, ka shumë qëndrime të mira. Më kanë përkrahur moralisht shumë, por edhe financiarisht deri diku. Ky event do të bëhet më 20 korrik të këtij viti”, tregon tutje Zeqiri, një boksier fantastik dhe një djalosh modest dhe mjaft punëtor.

Kundërshtari i 20 korrikut dhe spektakli në Garanë

Zeqiri e ka zbuluar nacionalitetin e kundërshtarit të tij të 20 korrikut. Gjithashtu, ka folur edhe më detajisht për garën gala që do të mbahet në fshatin e Kërçovës gjatë verës që po vjen. “Avdyll Salihu është menaxher dhe promoteri i kësaj galaje. Kundërshtari do të jetë nga Venezuela, po e zbuloj për ju këtë. Është një kundërshtar shumë i mirë, i ka 14 fitore e 2 humbje. Shpejt do ta zbulojmë edhe

emrin e tij”, shprehet Zeqiri. “Kam garuar në Tetovë, kam garuar në Kërçovë dy herë, në qytet, por në fshatin ku kam lindur nuk kam pasur meç ende. Është ambient i hapur, stadiumi me bar artificial. Me garuar në fshat është pak më problem edhe për boksierët tjerë. Ndryshe është në qytet, duhet t’i bindësh që të boksojnë në fshat pasi janë mësuar në qytet. Do të ketë edhe gjashtë luftëra tjera, meçi im do të jetë kryesori. Është një luftë tepër e rëndë, sepse bokson në vendlindje”, shton ai. Mersim Zeqiri është lindur në Kërçovë, por është rritur në Zvicër, ku jeton dhe vepron, duke i gërshtuar sportin me biznesin, por rëndësi të madhe i kushton mbi të gjitha familjes. Pasi u zhvillua në një vend multikulturor, me nacionalitete të ndryshme, ai ka përkrahës dhe fansa të shumtë shqiptarë, por edhe të huaj. Ata i konsideron si mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e karrierës së tij. “Përkrahja e publikut është shumë e rëndësishme. Pa shikueshmëri nuk do të ishim këtu ku jemi, pa ata njerëz që na ndjekin, që e duan këtë sport, nuk mund të arrish nëse nuk e ke publikun pas vetes. “Unë jam rritur në Zvicër, ka edhe italianë, portugezë, publiku është i hapur. Sidoqoftë, shqiptarët janë në vendin e parë që na përkrahin, prej Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut”, thotë tutje Zeqiri. Zeqiri po e shijon çdo moment në boksion profesionist dhe synon të jetë mjaft i suksesshëm. Me titujt që mendon t’i fitojë gjatë verës në Maqedoninë e Veriut, nuk e ka ndërmend të ndalet pasi e ka karrierën përpara dhe zbulon se do të synojë edhe tituj të tjerë të Federatave të tjera. “Mersimi do të shkojë shumë lart. Fansat shqiptarë e përkrahin sportin e boksit shumë dhe besoj se kanë me më përkrah dhe për këtë besoj se do të shkojmë në majat e larta, që do të kryhen me sukses synimet që i kemi”, thekson Zeqiri. “Fokusi është të shkoj në majat e larta. Shpresoj të mos kem lëndime. Ka shumë për të arrit, ka shumë Federata. Njeriu është i lindur që nuk thotë kurrë boll, dëshiron gjithmonë të arrijë më shumë”, shprehet ai. Boksieri shqiptar është duke u përgatitur

për sfidën e radhës pasi e mbylli vitin 2023 në mënyrë fantastike. Ai zbulon se do të ushtrojë tek boksieri i njohur shqiptar, Arnold Gjergjaj, për t'u përgatitur sa më mirë të jetë e mundshme. "Përgatitjet ia kam nisur, jam duke i kryer tek boksieri i jonë Arnold Gjergjaj, po ndihem mjaft mirë aty. Abdullah Zymberi është pjesë e stafit e Enver Salihu është trajneri im, vëllai i Aziz Salihut", tregon ndër të tjera Zeqiri, i cili zbulon se në ring hyn zakonisht me këngët e Ilir Shaqirit, respektivisht me këngën ku flitet për Kërçovën, përkatësisht për një vajzë të këtij vendi, ndërsa e inspiron edhe çiftelia, një instrument që e ka në qejf dhe që tingëllon mirë sipas tij.

Mersim Zeqiri e tregon humanitetin e tij, i ndihmon të varfrit

Mersim Zeqiri e ka shfaqur edhe anën e tij humane duke e ndërmarrë një veprim vërtet për t'u duartrokatur. Për t'i ndihmuar nxënësit në nevojë, ai me menaxhmentin e tij e kanë menduar një metodë të jashtëzakonshme. Për këtë edhe i fton tifozët që të jenë në numër sa më të madh me praninë e tyre pasi kjo gala e boksit do ta ketë edhe një kauzë humaniteti. "Mund t'ju tregoj se 20 për qind e fitimeve nga shitja e biletave do të shkojnë për nxënësit e shkollës 'Mylo Gurra' në fshatin Strelcë, pra për nxënësit që iu duhet material për shkollë. Ideja është që t'ju ndihmojmë të varfërve", zotohet ai. Sporti nuk është gjithçka për Mersim Zeqirin. Ky djalë punëtor dhe i vyer i përkushtohet goxha shumë biznesit dhe familjes. Ai thotë se si sportist, familjar dhe afarist i mirë duhet të kesh kulturë e disiplinë në vetë. Mersimi ka folur edhe për biznesin e tij dhe për familjen, e cila e mbështet vazhdimisht në realizimin e synimeve dhe të ëndrrave. "Unë e kam biznesin, firmën e parketit, që shtrojmë parket dhe normal që merr kohë. Por, nëse i menaxhon punët mirë, çdo send mund ta kryesh. Pra, prej boksit, deri tek biznesi dhe familja, për gjithçka mund të gesh kohë", nënvizoi ai. "Janë 13

punëtorë që i kemi, pastaj marrim edhe punëtorë të përkohshëm apo sezonalë. Biznesi që e bëj unë më ka dhënë përjetime të shumta, pozitive, por edhe negative. Por, njeriu duhet të jetë i gatshëm dhe të keqen ta kthejë në të mirë", thotë boksieri shqiptar. "Ne shqiptarët jemi punëtorë, i mbajmë ndoshta edhe nga 2-3 punë. Jemi të krijuar qashtu, edhe pse nuk dua t'i nënçmoj nacionalitetet tjera. E kemi ndihmën e shtetit, është shumë më mirë se më përpara, hala më mirë po bëhet", shton Zeqiri, i cili është baba i tre fëmijëve. "E kam përkrahjen e familjes në maksimum për t'u marrë me boks. Përkrahja e tyre është gjithçka, është qëndrimi dhe shtylla. Nëse familja nuk të përkrah, është e vështirë të arrish suksese", thotë tutje ai. "Babi është kritikuesi im më i madh që ekziston, po flas për aspektin e mirë. Ai ma jep inspirimin, që unë i arrij punët që i kam bërë deri tash. Për çdo hap që e kam bërë ai më ka ndjekur dhe më ka përkrahur dhe këshilluar", tregon Zeqiri. Zeqiri e ka një jetë dhe agjendë mjaft të ngjeshur duke e pasur parasysh se duhet t'ju përkushtohet sportit, biznesit dhe natyrisht edhe familjes. Ai në intervistë për TV Syri ka treguar se si ia del ta menaxhojë kohën dhe t'i mbërrijë të gjitha. "Nëse punon, nëse je i disiplinuar, arrin gjithçka, me mirëmbajtje familjen, punën, sportin, shokët, krejt. Të gjitha këto përfshihen nëse je punëtor. Nëse s'je punëtor, s'mund ta mbash as sportin. Gjithçka është tek disiplina, jo tek talenti", tregon ai.

Krenar me arritjet e shqiptarëve

Mersim Zeqiri është njëri prej shumë shqiptarëve të suksesshëm të diasporës. Ai ndihet krenar që bashkatdhetarët po arrijnë suksese kudo dhe në sfera të ndryshme të jetës, ndërsa shpreson që sukseset të rriten dhe të zgjerohen. "Ne shqiptarët këtu në Zvicër kemi arritur shumë sidomos në sport. Gjithashtu, edhe në Maqedoninë e Veriut kemi arritur shumë, jemi duke shkuar mirë, po shihet edhe tash me këta dy tituj në

fshatin Garanë, por edhe me eventet tjera që mbahen atje. Jemi duke shkuar mirë, por shpresoj që ka me u bë më mirë, e mira nuk kryhet kurrë", nënvizoi Zeqiri. Tutje, Mersimi thotë se përmes sportit, në këtë rast boksit, e mëson se kush je, çka je, mëson që të kesh sabër, që me të nguc dikush nuk i jep hapësirë për me u kap me të se e din veten kush je. "Pjesa e boksit për fëmijët, njerëzit tanë, është shumë e mirë pasi je i disiplinuar, rri i qetë dhe s'mund të rrihesh me një person në rrugë ose jashtë diku. Sporti edhe të mirëmban, të bën sabërl, e ke kontrollin, s'don me i tregu askujt se kush je e çka je. Je i disiplinuar, e ruan atë që e ke përballë." Mersim Zeqiri i frekuenton kohë pas kohe rrjetet sociale, por nuk e humb kohën kot. Ai zbulon se ato i përdor kryesisht për sport dhe mundohet t'ua tregojë të rinjve rrugën e suksesit dhe të bëhet model dhe shembull për ta. "Nuk rri shumë në rrjetet sociale, por i përdori ato për sport, për këta të rinjtë që ta shohin ardhmëria e jonë se si një boksier për 7 muaj është ndeshur 5 herë, i ka 5 fitore dhe tash ndeshet për dy tituj. Çdo sport të largon prej sendeve të këqija, prej alkoolit, drogës dhe krejt të këqijave. Nuk do të rrih tek treni, tek stacioni, por do të shkosh në trening, do të kesh disiplinë, do të bësh ushtrime. Pra, ju ikën sendeve që janë të gabueshme", deklaroi Zeqiri, i cili thotë se nuk kërkon shumë që ta duan njerëzit, por gjithsesi ta respektojnë pasi edhe vetë mundohet të jetë sa më shumë respektues dhe respektin e shë mbi gjithçka në jetë. Zeqiri, një patriot me zemër, në fund iu bëri thirrje të gjithë atyre që do të kenë mundësi të jenë prezent në meçin e tij të radhës për të festuar në fund bashkërisht. "I falënderohem Zotit që e kam një familje të shëndoshë dhe ishalla krejt shqiptarët dhe nacionalitetet tjera të jenë mirë. Më e mira është që më 20 korrik të jenë të gjithë në fshatin Garanë në ring, aty jam tjetër person. Në jetën e përditshme jam shumë i qetë, në ring jam tjetër person. Ishalla do Zoti jemi shëndosh e mirë, besoj se do t'i kemi të shtruar në tavolinë dy tituj", përfundoi boksieri shqiptar, Mersim Zeqiri.

SHKURT

Osmani takohet me Dauphin, flasin për organizimin e LM "Prishtina 2030"

Zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, ka pritur në takim drejtorin regional për Ballkanin Perëndimor të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, Arnaud Dauphin dhe Melanie Malinvaud, menaxhere e projekteve në AFD për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut. Sipas njoftimit të MKRS-së, temë kryesore e diskutimit ishte organizimi i Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030". Gjithashtu u fol për zhvillimet dhe politikën e sportit në vend. Zëvendësministrja e njoftoi me përgatitjet aktuale që po bëhen për zhvillimin e LM2030, ndërsa folën për mundësinë e bashkëpunimit rreth organizimit të kësaj ngjarje të rëndësishme sportive. Agjencia Franceze e Zhvillimit shprehu gatishmërinë për investime në disa projekte në kuadër të LM2030 si dhe shkëmbimin e përvojës nga Lojërat Olimpikë që do të mbahen këtë vit në Paris.

Juventus nis punën për transferimin e Zhegrovës

Juventus në verë mund të nënshkruajë me yllin e Kosovës, Edon Zhegrova. "Zonja e Vjetër" rikthehet në Ligën e Kampionëve, prandaj do të investojë në afatin kalimtar, e një ndër nënshkrimet e mundshme është ylli kosovar i Lilles. Sipas gazetës më të madhe italiane "Gazzetta dello Sport", Zhegrova shihet si "art i driblmeve" nga drejtori i skuadrës Guintoli, i cili tashmë ka nisur punën për ta afuar. Juventus është i gatshëm t'i nisë negociatat edhe me Lillen, skuadër që do të kërkojë rreth 15 milionë euro për kartonin e kosovarit. Zhegrova kërkohet edhe nga RB Leipzig, Borussia Dortmund dhe Real Sociedad.

Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Real Madrid, Bayern Munchen, PSG-ja dhe Borussia Dortmund janë katër skuadrat që siguruan kualifikimin për në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Të enjten është shpallur edhe formacioni më i mirë i çerekfinaleve të kthimit në këtë garë. Dortmundi dominon me katër futbollistë. Më pas PSG-ja me tre dhe Real e Bayerni me nga dy. Formacioni: Lunin, Kimmich, Dier, Nacho, Maatsen, Zabitzer, Brandt, Dembele, Barcola, Mbappe, Fullkrug.

Ademi takon përfaqësuesit e FIFA-s

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, të mërkurën ka pritur përfaqësuesit e FIFA-s, Carl Brown dhe Rozeta Kokalari. Brown dhe Kokalari po qëndrojnë në Prishtinë që nga fillimi i kësaj jave për procesin e auditimit të FFK-së nga FIFA si dhe për ta parë ecurinë e projekteve të federatës për vitin 2023, që janë të lidhura me FIFA Forward 3.0. "Pata kënaqësinë t'i mirëpres përfaqësuesit e FIFA-s, Carl Brown dhe Rozeta Kokalari. Ata po qëndrojnë në Prishtinë që nga fillimi i kësaj jave për procesin e auditimit të FFK-së nga FIFA si dhe për ta parë ecurinë e projekteve të federatës për vitin 2023, që janë të lidhura direkt me FIFA Forward 3.0", ka shkruar Ademi në "Facebook". Sipas këtij njoftimi, projekte madhore të këtij programi ishin VAR si dhe ndriçimi i Kampit Nacional të FFK-së në Hajvali.



Leclerc: Sainzi po garon më mirë se unë

SHANGHAI, 18 PRILL - Ballafaqimi mes dy pilotëve të Ferrarit këtë sezon të Formula 1 është 3-0 për Carlos Sainz, që i ka fituar të gjitha duet direkte në pistë me shokun e tij të skuadrës Charles Leclerc. Madje spanjollit ka fituar edhe një garë, ndërkohë që mungoi në Jedah për shkak të

operacionit. Leclerc këtë sezon ka zhgënjyer edhe në armën e tij të fortë, provat zyrtare, ku jepte gjithnjë kohë të shkëlqyera. "Mendoj se është e thjeshtë. Sainz po bën një punë më të mirë", ka thënë Leclerc në prag të garës së Kinës që zhvillohet këtë fundjavë në pistën e Shanghai.

"Në Bahrein është e vështirë të bësh një krahasim, sepse kisha disa probleme me frenat. Megjithatë, në dy garat e fundit ai ka qenë më i fortë. Kështu që, tani më takon mua të punoj, veçanërisht në fazën kualifikuese, që zakonisht është një pikë e fortë", u shpreh monogasku.

"Sainz po piloton në një nivel shumë të lartë dhe mendoj se kjo është mirë për ekipin. Është e mrekullueshme edhe për mua. Unë kam punuar shumë në këtë aspekt dhe normalisht kur punoj në një aspekt, jam mjaft i sigurt se do të përmirësohem shumë shpejt. Duhet ta dëshmoj në



pistë duke filluar nga kualifikimet e Kinës", ka thënë Leclerc.

Ancelotti: Triumfi ndaj Cityt, motiv për ta fituar Ligën e Kampionëve. Guardiola: Urime Realit

MANCHESTER, 18 PRILL - Real Madridi eliminoi Manchester Cityn me penallti dhe u kualifikua në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve dhe do të përballlet me Bayern Munchenin. I lumtur për këtë sukses është shprehur trajneri Carlo Ancelotti, i cili ka thënë se mposhtja e Cityt është një mundësi për të fituar një tjetër Ligë të Kampionëve. "Jam shumë i lumtur. E dinim se duhej të vuanim dhe vuajtëm. Ishte një ndeshje shumë e vështirë, por në fund fituam. Jam shumë krenar për fazën e mbrojtjes sepse nuk jemi mësuar të bllokohejmë kështu. Zumë hapësirat dhe ishim kompaktë. Nuk është e lehtë të kesh më shumë kontroll në një ndeshje kundër Manchester Cityt. Ai është kampion i vërtetë. Goli na la prapa, nuk kishim nevojë të luanim në sulm. Ishte një gol i mirë, më pas luajtëm me kundërsulme dhe mund t'i kishim shfrytëzuar më mirë rastet. Titulli i 15-të i Ligës së Kampionëve? Së pari le të mendojmë për gjysmëfinalen. Në tre vitet e fundit kemi luajtur kundër Cityt dhe është më i miri në Evropë. Mposhtja e tij ishte një mundësi për të fituar një tjetër Ligë



të Kampionëve", u shpreh Ancelotti.

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, e ka përgëzuar Realin e Madridit për aftësinë për të rezistuar deri në fund. Ai është shprehur i kënaqur me mënyrën se si luajti skuadra e tij, por për fatin e keq nuk arriti të fitonte. "E përgëzoj Real Madridin për aftësinë për t'u mbrojtur dhe rezistuar deri në fund. Lojtarët e tij bënë një ndeshje shumë të mirë dhe ne nuk ia arritëm qëllimit. Mendoj se tri ndeshjet kundër Real Madridit që

luajtëm, e kemi bërë shumë mirë. Në 'Bernabeu' nuk luajtëm njësoj. Ne provuam gjithçka. Nuk jam penduar. Ne trajnerët gjithmonë përpiqemi të krijojmë më shumë dhe të pranojmë më pak në çdo ndeshje, sepse kjo të ndihmon të fitosh. Ne bëmë gjithçka si në mbrojtje ashtu edhe në sulm, ndërsa ata bënë mirë në mbrojtje dhe në kundërsulme, por dihet që Reali ka një nivel të lartë dhe cilësi të mahnitshme. Skuadra jonë luajti një ndeshje të mrekullueshme në çdo aspekt por, për fat të keq, nuk fituam", ka deklaruar Guardiola.

Philadelphia mposht Miamin në sekondën e fundit, shkon në 'play-off'

PHILADELPHIA, 18 PRILL - Philadelphia e mposhti me 105-104 Miamin në sfidën "play-in" të Konferencës së Lindjes në NBA,



duke siguruar një vend në fazën "play-off". Një ndeshje me

rivalitet deri në fundin e saj, ku për vendasit u dallua Joel Embiid me 23 pikë e 15 rebounde. Për Miamin, Tyler Herro realizoi 25 pikë, por që s'mjaftuan. Skuadra e Philadelphia do të luajë ndaj New Yorkut në çerekfinalen të "play-off", ndërsa Miami ka ende një shans për t'u kualifikuar. Ekipi nga Florida do të përballlet me Chicagon, që e mundi 131-116 Atlantan. Sfidë e komanduar nga Bullsi, që u shkëput gradualisht. Më i miri për Chicagon ishte Coby White, që realizoi 42 pikë.

KONFERENCA E PERËNDIMIT, "PLAY-IN"

New Orleans - Lakers 106-110
Sacramento - Golden State 118-94
(18/04) New Orleans - Sacramento

KONFERENCA E LINDJES, "PLAY-IN"

Philadelphia - Miami 105-104
Chicago - Atlanta 131-116
(19/04), Miami - Chicago

Nadali eliminohet nga turneu i Barcelonës

Tenisti spanjoll Rafael Nadal u eliminua këtë të mërkurë nga turneu i Barcelonës, të cilin e ka fituar në 12 raste, pasi humbi u mposht në dy sete nga australianit Alex De Minaur (7-5, 6-1). Pas një

debutimi të suksesshëm ndaj italianit Flavio Cobolli (6-2 dhe 6-3), 37-vjeçari nga Mallorca nuk arriti të imponohej ndaj një kundërshtari me pozicion më të lartë në renditjen ATP. Kundër vendit të 11-të në

hierarki dhe i katërti në turneu spanjoll, Nadali (644), fituesi i 22 turneve Grand Slam, përfundoi duke u eliminuar pas një ore e 54 minutash, me rezultatin 7-5 dhe 6-1. Të martën spanjollit

fitoi sërish në sipërfaqen e tij të preferuar, diçka që nuk kishte ndodhur që nga 5 qershori 2022, kur mposhti norvegjezin Casper Ruud, në tri sete, për ta fituar titullin e tij të 14-të në Roland Garros dhe

për t'i zgjeruar rekordet e tij. Nadali nuk ka luajtur asnjë ndeshje zyrtare që nga turneu në Brisbane në fillim të janarit, kur u rikthye pas një viti mungesë për shkak të lëndimit.

SHKURT

Arteta pas eliminimit nga Liga e Kampionëve: Jemi të zhgënjyer

Bayern Muncheni e ka eliminuar Arsenalin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve me rezultat të përgjithshëm 3-2. Pas ndeshjes trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka thënë se janë të zhgënjyer. "Dhoma e zhveshjes me të vërtetë e shkatërruar. Jemi të zhgënjyer. Nuk mund të gjej fjalët e duhura për t'ua thënë atyre. Është momenti për të qëndruar pranë lojtarëve dhe për t'i mbështetur, sepse ata na kanë çuar në këtë rrugë", u shpreh Arteta.

Roma ia vazhdon kontratën De Rossit

AS Roma ka njoftuar për vazhdimin e kontratës së Daniele De Rossit trajneri i kryeqytetasve edhe pas përfundimit të këtij sezoni. "Pas një takimi të mbajtur dje pasdite me Daniele De Rossi, ne jemi të kënaqur të njoftojmë se ai do të vazhdojë ta mbajë postin e trajnerit të AS Roma edhe në fund të këtij sezoni dhe për një të ardhme të parashikueshme. Në mandatin e tij të shkurtër si trajner, ndikimi pozitiv që lidhshipi i tij solli në të gjithë klubin vazhdoi tregimin e historisë së tij të jashtëzakonshme me Romën. Udhëheqja e Daniele karakterizohet nga respekti dhe guximi, ndërsa forca dhe besimi i tij, të rrënjësuar thellë në klub, janë në përputhje me vlerat e Romës, qytetit dhe tifozëve tanë. Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku me përkushtim gjithnjë e më të madh për të ofruar të ardhmen që tifozët e Romës meritojnë. Nuk mund të ishim më të lumtur të ndërtonim një projekt afatgjatë me Daniele. Detaje të tjera do të pasojnë në ditët në vijim. Forza Roma!", deklarata e firmosur nga Dan dhe Ryan Friedkin.

Kane: Do të bëjmë gjithçka për të luajtur në 'Wembley'

Sulmuesi Harry Kane ka thënë se për të luajtur një finale në "Wembley" është një ëndërr dhe se Bayern Munchen do të japë gjithçka për të realizuar këtë ëndërr. "Ishte një ndeshje shumë e ekuilibruar, pak edhe e çmendur. Objektivi i vetëm ka mbetur Liga e Kampionëve, kjo të jep një ndjesi speciale. Për mua kjo sfidë kishte shumë kuptime, në një kohë kur kam luajtur për shumë vite me Tottenhamin. Çfarë do të thotë një finale në "Wembley"? Do të ishte një rrugëtim i shkëlqyer, por tani duhet të mendojmë për gjysmëfinalen. Do të ishte një ëndërr për mua të luaja në "Wembley", do të bëj gjithçka për ta realizuar këtë ëndërr", u shpreh Kane. Bayerni e mposhti Arsenalin në çerekfinale, kurse në gjysmëfinale do të përballlet me Real Madridin.

Leverkuseni kërkon 150 milionë euro për Wirtzin

Bayer Leverkuseni i ka vendosur një çmim të madh të shumëkërkuarit Florian Wirtz, ku nuk mungon interesimi nga Barcelona dhe Real Madridi. CEO i Bayer Leverkuseni, Fernando Carro, deklaroi qartë se klubi do të jetë i gatshëm ta shesë lojtarin në afatin e ardhshëm të transferimit të verës, me kusht që skuadra e interesuar të paguajë një tarifë transferimi prej 150 milionë eurosh. 20-vjeçari, i cili bëri debutimin e tij profesional për skuadrën e Bundesligës në vitin 2020, ka një kontratë të vlefshme deri në vitin 2027. Wirtz nën drejtimin e Xabi Alonsos ka luajtur në 41 ndeshje në të gjitha garat ku ka shënuar 17 herë dhe ka dhënë 18 asistime. "Askush nuk është i pashitshëm, por për më pak se 150 milionë euro, Wirtz nuk do të largohet", ka deklaruar Carro.

Thirrje për Aplikim

Kompania: **SERA KOOP SH.P.K**

NUI: 812134401

Adresa: Rr, Agim Gashi, Pa nr-Sferkë-Klinë.

Kërkon ofertues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licensuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m²) me profile të zinguarra komplet.

Investimi në ***Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m²) me profile të zinguarra komplet***, do të bëhet në adresën: **Rr, Agim Gashi, Pa nr-Sferkë-Klinë.**

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë në email: **gashi.luan11@gmail.com** ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes. Ndërsa, afati kohor për marrjen e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, gjithësej pësembedhjet (15) ditë janë procedurat e prokurimit.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:

+383- 049-618-724

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Diamanti Cleaning” SH.P.K. me pronar Liridon Gela, me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811870949 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Diamanti Cleaning” D.O.O. Liridon Gela Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811870949 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Diamanti Cleaning” L.L.C. Liridon Gela Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811870949 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Smart Com D.O.O. Branch Office In Kosovo Dega në Kosovë” me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810802828 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Smart Com D.O.O. Branch Office In Kosovo Dega në Kosovë” Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810802828 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Smart Com D.O.O. Branch Office In Kosovo Dega në Kosovë” Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810802828 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Resmije Mahmutaj nga Gerqina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f. “7 Shtatori” Gerqinë nga kl. 1-8.

-Shaqir Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” QAMO Gjakovë.

-Behar Mullaibrahimi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” dega Gjeodezi.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për

informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.



NJOFTIM PËR KONTRATË

Ri-shpallje

(Furnizim)

Procedurë e hapur

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 24 016.1 121
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: **"Furnizim me material shpenzues hixhienik"**

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, 10000 Prishtinë, Rr. "Garibaldi" nr. 33

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përshtatshëm çmimi më i lirë" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 30.04.2024 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 29.04.2024 ora 14:00

V.2 Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Data: 02.05.2024, ora 14:00

V.3 Sigurimi i tenderit: 1,000.00 € (një/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite.

V.4 Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj që nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 02.05.2024, ora 14:30. Vendi: Auditoriumi i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)", respektivisht sipas Neni 41 të këtyre Rregullave, "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

